



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE TIRANË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE INDUSTRIALE "PAVARËSIA "VLORË

Nr. 388 Prot

Vlorë , më 15.07.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë ,27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE "PAVARESIA "VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicione pune :

Pozicioni 1: Magazinier

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin si vijon:

- a)të ketë zotësi të plotë përtë vepruar
- b)të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c)të mos jetë I dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d)të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e)të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjelljes dhe komunikimit
- f)të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për shpallje të vendit të lirë në pozicionin magazinier në ofruesit e AFP-së si vijon:

- a) të ketë nivel arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale ,në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës .
- b) të ketë përvojë në punë të paktën 1 (një) vit sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.

Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për shpallje të vendit të lirë , duhet të përfshijë: -

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën
- e)- librezën e punës;
- f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- h) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- i) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
3. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda dates, 25.07.2024

DREJTOR
ING.GENTIAN BOCI

